



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës/Direkcija za Obrazovanje i Kulturu

Në bazë të nenit 5, shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, dhe duke u bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën E Kosovës Nr. 04/L-32 si dhe në Udhëzimet Administrativ Nr. 22/2013 për Numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, si dhe në pajtim me udhëzimet dhe/ose procedurat dhe standardet e përgjithshme të shpallura nga MASHT:

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT (DKA) SHPALL

KONKURS/GUSHT 2024

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË SHKOLLËS
PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2024/2025

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë(10) në Shkollën e Mesme Ekonomike për vitin shkollor 2024/2025.

Nr.	Shkolla	Nr.i paraleleve	Nr. i nxënësve	Lëmia dhe profili	Gjithsej
1	Shkolla e Mesme Ekonomike	1	20	Ekonomi Kontabilitet dhe Tatime	20
2	Shkolla e Mesme Ekonomike	1	20	Ekonomi Marketing dhe Shitje	20
Totali		2	40		40

Konkursi shpallet me këto kushte dhe kritere:

Kushtet e regjistrimit:

Për regjistrim nxënësve në klasën e 10-të, në Shkollën e Mesme Ekonomike për vitin shkollor 2024/2025, mund të konkurojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9^{-të} jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë njohjen e dëftesave në MASHTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në këtë gjimnaze dhe shkolla profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollë në të cilën konkurron)
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikatën e lindjes.

Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

- Paraqitja e dokumenteve për shkolla profesionale për vitin shkollor 2024/2025, bëhet më datën **19-20 dhe 21 Gusht 2024**, në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora **08:00-16:00**.
- Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollën përkatëse me datën **22.08.2024** (në shkollat ku plotësohet numri).
- Shpallja e konkursit plotësues në muajin gusht për vendet e lira bëhet me **22.08.2024**, (në shkollat ku nuk plotësohet numri i nxënësve dhe vazhdon konkurrimi).
- Dorëzimi i dokumenteve për konkursë plotësues bëhet me datën **19,20 dhe 21 gusht 2024 për nxënësit**.
- Shpallja e rezultateve për konkursë plotësues bëhet me datën **22.08.2024**
Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit brenda (2) dy ditë pune , pas pranimit të përgjigjes nga shkolla.

Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

1. Suksesi nga shkollimi i obliguar (40%) 40 pikë
2. Suksesi nga lëndët prioritare nga shkollimi i obliguar (20%) 20 pikë
3. Numri i pikëve nga testi (40%) 40 pikë

Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6-9) mund t'i fitojë maksimalisht 40 pikë. Formula për Llogaritjen e pikëve të suksesit është: (mes.kl.6 + mes.kl. 7 + mes.kl.8 + mes.kl.9) x2 = 40 pikë max. Nxënësi nga suksesi në lëndët prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 20 pikë, shuma e mesatares së 4 lëndëve shumëzohet me 2. (mes. lënda (I) + mes. lënda (II) + mes. Lënda(III) + mes. Lënda (IV)x2=20 pikë Max , si dhe numri i pikëve nga testi 40 pikë

3. Renditja e lëndëve me prioritet sipas profileve në shkolla profesionale

Ekonomi

- Matematik dhe Informatik 50
- Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 50
- Shkenca shoqërore 50
- Shkencat natyrore 50

$$50 \times 0.4 = 20 \text{ pikë}$$

$$50 \times 0.2 = 10 \text{ pikë}$$

$$50 \times 0.15 = 7.5 \text{ pikë}$$

$$50 \times 0.05 = 2.5 \text{ pikë}$$

$$\text{Totali} = 40 \text{ pikë}$$

Në Novobërdë
Më, 19.08.2024



Drejtori i DAK-ut
Simisa Dimic